



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup

Shqyrtimi i Raportit të BE-së për Sundimin e Ligjit 2025, me fokus mbi raportin për Maqedoninë e Veriut

Shqyrtimi i Raportit të BE-së për Sundimin e Ligjit 2025, me fokus mbi raportin për Maqedoninë e Veriut

Botues:

Instituti për politikë evropiane - Shkup

Për botuesin:

Dr. Simonida Kacarska

Përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:

Blerina Starova Zlatku

Dizajn grafik:

Relativ

Tetor, 2025

Shkup



Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Ndërtim urë për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i së drejtës në drejtim të aderimit në BE", i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesi nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja:

Lista e shkurtesave	4
Hyrje	5
Dimensione të reja	6
Trendet	6
Shqyrtimi i Raportit të vendit për Maqedoninë e Veriut	7
Metodologjia	7
Gjyqësori nën presion të shtuar	7
Lufta kundër korrupsionit: pa një histori të "fortë" arritjesh	9
Media	10
Çështje të tjera institucionale që lidhen me kontrollet dhe balancat	11
Përfundime dhe rekomandime	13
Shtojcë: Pasqyrë e përparimit, çështjeve të përsëritura dhe gjetjeve/çështjeve të reja	15

Lista e shkurtesave

ASHMAA - Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele

KE - Këshilli i Evropës

OSHC - Organizatat e shoqërisë civile

KE - Komisioni Evropian

BE - Bashkimi Evropian

TI - Teknologjia e Informacionit

RTM - Radio Televizioni i Maqedonisë

RSL- Raporti i BE për Sundimin e Ligjit

KSHPK - Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit

SLAPP - Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike

Hyrje

Raporti i Sundimit të Ligjit (RSL) është një instrument thelbësor i Bashkimit Evropian (BE), që shërben si një mjet diagnostikues por edhe si një mekanizëm parandalues për të monitoruar gjendjen e sundimit të ligjit në të gjitha Shtetet Anëtare. Duke vlerësuar fushat kryesore, përfshirë sistemin e drejtësisë, masat anti-korrupsion, pluralizmin mediatik dhe kontrollet dhe balancat institucionale, Raporti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të pikave të forta dhe sfidave brenda fushës së sundimit të ligjit.¹

Pika fillestare është se sundimi i ligjit është baza mbi të cilën qëndron fort BE-ja, ndërsa në botën e sotme "rendi ndërkombëtar i bazuar në rregulla, respekti për të drejtat themelore dhe sistemet demokratike janë nën presion të shtuar".²

Një element kyç i këtij instrumenti është dialogu - si metodë pune poashtu dhe si mjet për promovimin e kulturës së dialogut të hapur.

Raporti i këtij viti për sundimin e ligjit është raporti i pestë i tillë për Shtetet Anëtare të BE-së dhe i dyti, në të cilin përfshihen vendet kandidate Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, me mundësinë e përfshirjes së shteteve të tjera kandidate "kur ato të jenë gati".³

Rëndësia e këtij raporti për shtetet kandidate rritet me forcimin e Grupit "Themelet", duke mbuluar sundimin e ligjit dhe duke vepruar si katalizator për procesin e anëtarësimit.

1 Për më shumë detaje, shih Institutin e Politikave Evropiane 2025, Shqyrtim vjetor për sundimin e ligjit të BE-së 2024, (Annual Insight in EU Rule of Law 2024), Shkup, janar <https://epi.org.mk/post/30958>

2 Komisioni Evropian 2025, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve: 2025 Raporti i Sundimit të Ligjit - Situata e Sundimit të Ligjit në Bashkimin Evropian, Strasburg, 8 korrik 2025, COM(2025) 900 përfundimtare, f 1., https://commission.europa.eu/document/download/0f7b852b-6b8a-4e21-8579-69db5386c6a2_en?filename=1_1_63910_communication_rol_en.pdf.

3 Ibid., f 2.

Dimensione të reja

Përmbajtja dhe metodologjia e Raportit të këtij viti pasurohen me dimensionin e Tregut të Vetëm. Janë identifikuar aspektet kyçe të sundimit të ligjit që ndikojnë në Tregun e Vetëm dhe mjedisin e biznesit, dhe këto janë përfshirë si bazë për vlerësimin e gjendjes në pjesët përkatëse të raporteve.⁴ Kjo është gjithashtu e rëndësishme për vendet candidate, duke marrë parasysh mundësitë për integrim të përsheptuar dhe gradual në Tregun e Vetëm të BE-së.

Dimensioni i dytë i theksuar i Raportit për vitin 2025 lidhet me përgatitjet për buxhetin e ri shumëvjeçar të Bashkimit (Kudri Financiar Shumëvjeçar 2028–2034). Po shqyrtohen masa të reja sigurie në instrumentet e ardhshme të BE-së për të siguruar përputhshmërinë dhe për të krijuar një lidhje më të ngushtë midis rekomandimeve në Raportin për Sundimin e Ligjit dhe mbështetjes financiare nën buxhetin e BE-së⁵, përveç kushtëzimit të sundimit të ligjit që tashmë është përfshirë në zbatimin e fondeve të BE-së. Për më tepër, është planifikuar një rishikim i arkitekturës të BE-së kundër mashtrimeve.

RSL do të plotësohet nga iniciativa të reja, të tilla si Mburoja Evropiane e Demokracisë dhe Strategjia e parë e BE-së për Shoqërinë Civile.

Trendet

Raporti paraqet një pamje të larmishme të gjendjes të sundimit të ligjit në vende të ndryshme. Paralelisht me konfirmimin e "një trajektoreje pozitive në shumë shtete anëtare"⁶, Raporti gjithashtu thekson se "sfidat sistemike në disa vende mbeten"⁷, ndërsa BE po përballet me "polarizim politik në rritje, presion mbi institucionet demokratike, sfida mbi ekonominë tona dhe kërcënime të jashtme në rritje".⁸

Megjithatë, niveli i zbatimit të rekomandimeve krahasuar me raportin e vitit të kaluar është ulur. Ndërsa Shtetet Anëtare zbatuan plotësisht ose pjesërisht 68% të rekomandimeve nga Raporti në vitin 2023, në vitin 2024, vetëm 57% e rekomandimeve u zbatuan plotësisht ose pjesërisht.

4 Këto aspekte përfshijnë, për shembull: trajtimin e çështjeve komerciale; mekanizmat për zbatimin e vendimeve gjyqësore; masat për parandalimin e korrupsionit në prokurimet publike; financimin transparent për mediat; dhe mjedisin e qëndrueshëm rregullator të nevojshëm që bizneset të funksionojnë në kushte të parashikueshme; funksionimin efektiv dhe pavarësinë e autoriteteve rregullatore, si dhe shqyrtimin gjyqësor të vendimeve administrative. Raporti gjithashtu përfshin të dhëna për perceptimet e bizneseve në lidhje me efektivitetin e mbrojtjes së investimeve nga ligji dhe gjykatat, si dhe pavarësinë e organeve të shqyrtimit të prokurimit publik dhe të autoriteteve kombëtare të konkurrencës.

5 Komisioni Evropian 2025, Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve: 2025 Raporti i Sundimit të Ligjit - Situata e Sundimit të Ligjit në Bashkimin Evropian, Strasburg, 8 korrik 2025, COM(2025) 900 final, f. 4. https://commission.europa.eu/document/download/0f7b852b-6b8a-4e21-8579-69db5386c6a2_en?filename=1_1_63910_communication_ro_en.pdf.

6 Komisioni Evropian 2025, IP 25 1742. https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_25_1742

7 Komisioni Evropian 2025, Shënime nga Komisioneri McGrath, (Remarks by Commissioner McGrath) Strasburg, 8 korrik 2025. https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/pl/speech_25_1776

8 Komisioni Evropian 2025, Shënime nga Zëvendës Kryetarja Virkkunen, (Remarks by Vice-President Virkkunen) Strasburg, 8 korrik 2025. , https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/pl/speech_25_1776

Shqyrtimi i Raportit të vendit për Maqedoninë e Veriut

Metodologjia

Kemi analizuar përmbajtjen e gjetjeve në secilën nga shtyllat, temat dhe seksionet e Raportit⁹, siç klasifikohet në Metodologjinë e KE-së për përgatitjen e RSL-së vjetore.¹⁰ Ne kemi krahasuar gjetjet tona me ato të RSL 2024, si dhe me raportin e fundit vjetor të vendit. Duke marrë parasysh strukturën e dallueshme të RSL dhe Raportit Vjetor (i cili organizohet sipas kriterëve, nën-kriterëve, fushave, etj.), kemi identifikuar të njëjtat tema në të dy raportet. Ne kemi marrë parasysh komplementaritetin e dy raporteve, si dhe dallimet e tyre. RSL analizon më hollësisht gjendjen në këtë fushë, por nuk përfshin rekomandime, pasi këto përfshihen në Raportin Vjetor të Vendiut.

Analiza e teksteve bazohet në një metodologji cilësore. Kemi identifikuar posaçërisht gjetjet që shënojnë përparim në krahasim me raportet e mëparshme, si dhe ato që tregojnë probleme të përsëritura dhe çështje të reja që kanë dalë në pah.

Analizuam gjithashtu lidhjen me hapat e parashikuar në Agjendën e Reformave, duke u fokusuar në ata që pritet të zbatohen deri në fund të vitit 2026.

Nga analiza kemi nxjerrë konkluzione dhe rekomandime kyçe.

Gjyqësori nën presion të shtuar

Përveç "shqetësimeve serioze" të shprehura tashmë në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit për shkak të "ndikimeve të jashtme" dhe "ndërhyrjeve" në Raportin 2024 dhe RSL 2024, RSL e këtij viti specifikon këtë kritikë. Tani ai i referohet drejtpërdrejt degëve të tjera të pushtetit si burim i ndërhyrjeve dhe presioneve, duke e ilustruar këtë pretendim me njoftimet e Qeverisë për shpërbërjen e Këshillit Gjyqësor dhe atij të Prokurorëve Publikë; mocionet e interpelancës kundër anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të zgjedhur nga Parlamenti; procedurën e nisur për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm; dorëheqjen e Kryetares së Këshillit Gjyqësor, duke përmendur presionet e pajustificuara politike si arsye; si dhe fushatat publike denigruese kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë nga zyrtarë të lartë të ekzekutivit dhe politikanë.¹¹

9 Komisioni Evropian 2025, Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: 2025 Raporti për sundimin e ligjit – Kapitulli i vendit për situatën e sundimit të ligjit në Maqedoninë e Veriut, (2025 Rule of Law Report – Country Chapter on the Rule of Law Situation in North Macedonia), (SWD(2025) 930 final, Strasburg, 8 korrik 2025). https://commission.europa.eu/document/download/ede31053-efc6-4dd0-89ed-c9224f7eeb70_en?filename=2025%20Rule%20of%20Law%20Report%20-%20Country%20Chapter%20North-Macedonia.pdf

10 Komisioni Evropian 2025, Dokumenti 72742fd9-3ce0-4d23-9086-58f885f84cdd <https://commission.europa.eu/document/72742fd9-3ce0-4d23-9086-58f885f84cdd>

11 Komisioni Evropian 2025, Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit: 2025 Raporti për sundimin e ligjit – Kapitulli i vendit për situatën e sundimit të ligjit në Maqedoninë e Veriut, (2025 Rule of Law Report – Country Chapter on the Rule of Law Situation in North Macedonia), (SWD(2025) 930 final, Strasburg, 8 korrik 2025), f. 2–3. https://commission.europa.eu/document/download/ede31053-efc6-4dd0-89ed-c9224f7eeb70_en?filename=2025%20Rule%20of%20Law%20Report%20-%20Country%20Chapter%20North-Macedonia.pdf

Perceptimi i pavarësisë së gjyqësorit, si në mesin e publikut të gjerë ashtu edhe të kompanive, shihet si shumë i ulët. Megjithatë, ndryshe nga përqindjet më të cituara publikisht, RSL tregon 28% besim ("mjaft i mirë" ose "shumë të mirë") nga publiku i gjerë dhe 26% nga kompanitë¹² që, megjithëse duket paradoksale, është ende më e mirë se rezultatet e sondazhit të mëparshëm në 2024 (25% dhe 20%).¹³

Raporti identifikon mungesën e burimeve financiare dhe njerëzore, si edhe mangësitë në monitorim dhe koordinim, si faktorë kyç që kontribuojnë në zbatimin e pamjaftueshëm të Strategjisë për Zhvillimin e Sistemit të Drejtësisë (normë zbatimi 42.9% në vitin 2024).

Është shënuar përparim në të gjithë gjyqësorin në rritjen e transparencës, me njohje të veçantë të përpjekjeve të Gjykatës Supreme, si dhe Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Megjithatë, vërehet se rregullat e reja të procedurës të miratuara nga Këshilli Gjyqësor në vitin 2024, në lidhje me shpjegimet për përzgjedhjen/mospërzgjedhjen e gjyqtarëve, ende zbatohen në mënyrë jo konsistente, ndërsa vendimet përkatëse të Këshillit të Prokurorëve Publikë vlerësohen si më pak transparente.

Raporti vëren gjithashtu proceset aktuale të hartimit të legjislacionit për ligjet që rregullojnë Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë, si edhe Ligjin për Prokurorinë Publike, të gjitha të paraqitura në Komisionin e Venecias për mendimin e tij.¹⁴ Këto ligje janë pjesë e Agjendës së Reformës, sipas së cilës Ligji për Këshillin Gjyqësor duhet të miratohet deri në qershor 2025 dhe dy të tjerat deri në fund të këtij viti.¹⁵

Burimet e kufizuara financiare dhe njerëzore gjithashtu vazhdojnë të ndikojnë në cilësinë e gjyqësorit.

Është përsëritur gjetja se buxheti për gjykatat dhe prokuroritë nuk ndahet në përputhje me Ligjin, si edhe fakti që pagat mbeten të ngrira. Edhe pse nuk përmendet qartë në këtë Raport, pritej që deri në qershor 2025 të miratoheshin ligje shtesë, përfshirë ato për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe ligji që rregullon shërbimin në administratat gjyqësore dhe prokuroriale. Gjithashtu, theksohet se miratimet ende të nevojshme nga Ministria e Financave për shpërndarjet e brendshme nuk u lejojnë atyre autonomi buxhetore.

Edhe pse pranohet se emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë në fillim të vitit 2025 ka ndihmuar në përmirësimin e situatës, shqetësimet mbeten për sa i përket numrit të gjyqtarëve, veçanërisht numrit të prokurorëve publikë, si dhe burimeve të tjera njerëzore të nevojshme për gjyqësorin. Rrjedhimisht, vlerësimi se strategjitë për burimet njerëzore në gjykata dhe prokurori publike nuk po zbatohen nuk është për t'u habitur. Shqetësim shtesë përbën fakti se në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë nuk është rekrutuar asnjë gjeneratë e re praktikantësh. Kjo gjendje gjithashtu vë në rrezik arritjen e një prej objektivave të Agjendës së Reformës - që vendet boshe për gjyqtarë dhe prokurorë duhet të plotësohen rregullisht bazuar në parashikimet e përcaktuara për dhjetor 2026.

Megjithëse njihet përpjekjet drejt digjitalizimit dhe funksionimit të sistemit automatik të menaxhimit të lëndëve, Raporti arrin në përfundimin se sfidat kryesore të infrastrukturës së vjetëruar, mbështetjes së pamjaftueshme të TI-së dhe zbatimit jo konsistent të mjeteve digjitale mbeten.

12 Komisioni Evropian 2025, Eurobarometer 2025, <https://europa.eu/eurobarometer/surveys/detail/3412>

13 Komisioni Evropian 2024, Eurobarometer 2024, <https://europa.eu/eurobarometer/surveys/detail/3193>

14 Komisioni i Venecias 2025, Opinioni për Ligjin për Këshillin Gjyqësor, qershor 2025; Opinioni për Ligjin për Prokurorinë Publike dhe Këshilli i Prokurorisë Publike, tetor 2025 (marrë pas publikimit të RSL).

15 Është e mundshme që miratimi i vonuar i këtij ligji të shkaktojë vonesa në dy objektivat pasuese të Agjendës së Reformave: Anëtarë të rinj të Këshillit Gjyqësor (duke zëvendësuar ata të cilëve u ka skaduar mandati) të zgjedhur në përputhje me ligjin e ndryshuar deri në dhjetor 2025; i njëjti afat vlen edhe për hapin "Gjyqtarët dhe prokurorët që i nënshtrohen procedurave disiplinore kanë të gjitha garancitë e një gjykimi të drejtë."

Një çështje shqetësuese është rënia e vazhdueshme e efikasitetit gjyqësor, e cila dikur ishte një arritje e rëndësishme e reformës gjyqësore në dekadat e mëparshme. Përveç lëndëve administrative, civile dhe komerciale të shkallës së parë, të dhënat e paraqitura tregojnë përkeqësim të efikasitetit në të gjitha llojet e tjera të lëndëve.

Lufta kundër korrupsionit: pa një histori të "fortë" arritjesh

Pavarësisht perceptimit të korrupsionit në nivel të lartë, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit ka treguar përmirësim në vitet e fundit.¹⁶

Në përgjithësi, gjetjet në të gjitha aspektet e kësaj pjese të raportit janë kryesisht në përputhje me ato të RSL-së së mëparshme.

Zbatimi i Strategjisë për Parandalimin e Korrupsionit mbetet i ulët, megjithëse ka treguar një përmirësim të lehtë në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.¹⁷ KE citon vlerësimin e KSHPK-së, i cili konsideron se zbatimi i ulët pasqyron mungesën e përgjithshme të angazhimit politik dhe pronësisë midis institucioneve shtetërore. Analiza e arsyeve për moszbatimin e Strategjisë shërben si bazë për hartimin e një Strategjie të re për periudhën 2026–2030.

Konstatimi se **Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit** përqendrohet në parandalimin dhe bashkëpunimin institucional, dhe është më pak aktiv në zbulimin dhe raportimin e rasteve të pretenduara të korrupsionit, përsëritet në Raportin e këtij viti.

Vihet re aftësia e pamjaftueshme e KSHPK-së për të verifikuar **deklarata pasurie**, dhe numri i verifikimeve sistematike të pasurive ka rënë nga 2023 në 2024.

Zbatimi i Ligjit të ri për **Lobim** ka filluar; megjithatë, sipas KE, numri i lobistëve të regjistruar (3) dhe subjekteve të lobuara (32) mbetet i vogël.

Vihet re se mbrojtja e sinjalizuesve mbetet e dobët, ndërsa ligji i sapo përgatitur nuk është zbatuar pas zgjedhjeve parlamentare.

Përsëri vërehet mungesa e mbikëqyrjes efektive të **financimit të partive politike**, e cila, sipas Raportit, pengohet nga një kornizë ligjore joadekuate dhe mungesë e burimeve dhe ekspertizës brenda KSHPK-së.

Shëndetësia dhe prokurimi publik identifikohen si zona me rrezik të lartë korrupsioni. Raporti gjithashtu vë në dukje kritikën e KSHPK-së ndaj Ndryshimeve në Ligjin për Prokurimin Publik të miratuar në janar 2025. Çështja e ndikimit politik në punësimin e sektorit publik është një temë e përsëritur.

Raporti njeh "përpjekjet e fundit në hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit", por vëren se ende nuk ka të dhëna "të fuqishme" të rasteve të korrupsionit të profilit të lartë, pasi ato shpesh përballen me vonesa ose rezultojnë në dënime minimale, dhe hetimet rrallë çojnë në dënime përfundimtare. Theksohet mungesa e prokurorëve publikë dhe burimeve për luftimin e korrupsionit. Hapat e lidhur me Agjendën e

¹⁶ Raporti citon Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International për vitin 2024, ku indeksi për Maqedoninë e Veriut është 40/100 dhe renditet e 88 në nivel global, krahasuar me 35/100 në vitin 2020. Megjithatë, indeksi i vitit 2024 është më i ulët se ai i vitit 2023 (42/100).

¹⁷ Sipas raporteve të cituara të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), 55% e aktiviteteve të planifikuara në vitin 2023 nuk janë zbatuar, krahasuar me 50% në vitin 2024; në vitin 2023 janë zbatuar 13%, krahasuar me 18% në vitin 2024.

Reformës përfshijnë sigurimin që Prokuroria Publike për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin të ketë staf të plotë dhe të përshtatshëm, veçanërisht me prokurorë të specializuar, ekspertë financiarë dhe analistë digjitalë të mjekësisë ligjore, deri në dhjetor 2025, si dhe të ketë qendra hetimore plotësisht funksionale deri në qershor 2026. Për më tepër, deri në këtë afat duhet të tregohet rritje në numrin e hetimeve, aktakuzave të konfirmuara dhe dënimeve në rastet e korrupsionit, përfshirë edhe ato që përfshijnë zyrtarë të lartë; gjithashtu priten sekuestre dhe konfiskime përfundimtare në rastet e krimit të organizuar.

Megjithëse i kujdesshëm në ton, KE këtë vit shpreh shqetësim mbi ndikimin e mundshëm politik në përpjekjet për të trajtuar korrupsionin, si dhe qasjen selektive në hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit, "me disa raste potencialisht të nxitura nga konsideratat politike, në vend të një qasjeje gjithëpërfshirëse për të trajtuar korrupsionin në të gjitha partitë".¹⁸

Ky Raport gjithashtu thekson efektet negative të ndryshimeve të Kodit Penal në vitin 2023, duke njohur përpjekjet e gjykatave dhe Prokurorisë Publike për të ndjekur penalisht rastet e korrupsionit të lartë nën kushtet e reja, si dhe kapacitetin pjesërisht të përmirësuar. Për më tepër, KE vëren se, në shkurt 2025, Gjykata Kushtetuese i dha Kuvendit një afat gjashtëmuor për të korrigjuar dispozitat e kontestuara të Kodit Penal para Gjykatës. Po punohet për ndryshimin e Kodit Penal, i cili, sipas Agjendës së Reformës, pritet të miratohet deri në dhjetor 2025. Megjithatë, duke qenë se ligji nuk është ende në procedurë parlamentare, rreziqet e vonësës, si dhe boshllëqet e mundshme ligjore, mbeten të larta. Sipas Agjendës së Reformës, një Kod i ri Penal dhe një Ligj i ri për Procedurën Penale do të miratohen deri në fund të dhjetorit 2025. Megjithatë, ekziston një rrezik i lartë i vonësës ose adoptimit përmes një procesi jo gjithëpërfshirës, pa diskutim adekuat.

Media

Gjetjet mbi pavarësinë financiare dhe profesionalizmin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) janë pozitive. Megjithatë, kritika i referohet jo vetëm vonësës në emërim, por edhe profesionalizmit të anëtarëve të sapozgjedhur të Këshillit të ASHMAA-së¹⁹, si dhe mungesës së autonomisë institucionale. Raporti njeh përpjekjet e Këshillit të Etikës Mediatike, për të cilat duhet të sigurohet financim i qëndrueshëm. Vihet re se ky Këshill mori një të tretën më pak ankesa për gjuhën e urrëjtjes në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.

Raporti gjithashtu përmban kritika për mosemërimin e anëtarëve në Këshillin e Programit RTM që nga viti 2018, pasi anëtarët e Këshillit nuk ishin të informuar për këtë përditësim, pavarësisht se u zgjodhën në maj 2025. Është shënuar përparim në drejtim të financimit, duke pasur parasysh fondet buxhetore të parashikuara për RTM.

Kritika përsëritet për mungesën e transparencës së pronësisë së medias dhe rrezikun e mesatar deri të lartë të përqendrimit të mediave.²⁰

18 Komisioni Evropian 2025, Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit: 2025 Raporti i Sundimit të Ligjit - Kapitulli i vendit për situatën e sundimit të ligjit në Maqedoninë e Veriut, (2025 Rule of Law Report—Country Chapter on the Rule of Law Situation in North Macedonia), (SWD(2025) 930 final, Strasburg, 8 korrik 2025), f. 1 dhe 12 https://commission.europa.eu/document/download/ede31053-efc6-4dd0-89ed-c9224f7eeb70_en?filename=2025%20Rule%20of%20Law%20Report%20-%20Country%20Chapter%20North-Macedonia.pdf

19 Anëtarët e Këshillit u emëruan menjëherë para publikimit të Raportit.

20 RSL shpesh i referohet vlerësimeve të Monitorit të Pluralizmit të Medias (2025).

Raporti i referohet pikëpamjeve të palëve të interesuara se rivendosja e **reklamave shtetërore** mund të çojë në keqpërdorimin e fondeve shtetërore dhe të krijojë përçarje të tregut, si dhe në mediat e varura nga autoritetet për financim, që mund të minojnë pavarësinë e tyre editoriale dhe cilësinë e përmbajtjes.

Megjithëse kuadri ligjor është përmirësuar, duke përfshirë kapacitetin për të monitoruar dhe zbuluar rastet e **sulmeve ndaj gazetarëve**, sfidat në zbatim janë theksuar, veçanërisht në rastet e ngacmimit në internet, dhe dhunës me bazë gjinore ndaj gazetarëve femra, si dhe fushatave denigruese, veçanërisht kundër gazetarëve hulumtues. Mungon një kuadër ligjor specifik, si dhe ndërgjegjësimi për SLAPP (Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike). Përsëritet kritika për kushtet e papërshtatshme të punës për gazetarët, veçanërisht ata me angazhime afatshkurtra dhe kontraktuale.

Vendi ka bërë përparim me ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës (KE) për **Qasjen në Informacionin Publik**. Megjithatë, zbatimi i kuadrit ligjor në praktikë vazhdon të përballlet me sfida, si vonesat nga disa autoritete dhe përdorimi i mbrojtjes së të dhënave personale si justifikim.

Çështje të tjera institucionale që lidhen me kontrollet dhe balancat

Raporti arrin në përfundimin se Rregullorja e re e Punës së **Kuvendit**, e miratuar në vitin 2023, ka pasur një efekt pozitiv në efikasitetin e punës së tij, por ndikimi afatgjatë mbetet për t'u parë. Ndryshe nga RSL-ja dhe Raporti Vjetor i vitit të kaluar, RSL-ja e vitit 2025 nuk përmend "polarizimin politik". Vërejtjet e përsëritura i referohen emërimeve parlamentare të bëra duke mos marrë parasysh parimin e meritës, si dhe vonesës në emërime.

Kritika për mangësitë në procesin **epolitikëbërjes, gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në prova** përsëritet. Megjithëse koordinimi midis Qeverisë dhe Kuvendit në procedurën legjislativë vlerësohet si efektiv, vërehen mangësi në planifikimin, vlerësimin e ndikimit rregullator, monitorimin dhe evaluimin, si dhe në procesin konsultativ.

Në përputhje me lidhjen e theksuar **të sundimit të ligjit me Tregun e Vetëm dhe klimën e biznesit**, ky Raport përmban gjithashtu të dhëna mbi perceptimin e besimit të sektorit të biznesit në mbrojtjen e investimeve. Tridhjetë e shtatë përqind e kompanive vlerësojnë pjesërisht ose plotësisht se investimet mbrohen me ligj dhe nga gjykatat. E njëjta përqindje—37%—e konsideron nivelin e pavarësisë së organit të shqyrtimit të prokurimeve publike (Komisioni Shtetëror për Ankesa në Prokurime Publike) si shumë të mirë ose mjaft të mirë, ndërsa 31% e konsideron nivelin e pavarësisë së autoritetit kombëtar të konkurrencës (Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës) si shumë të mirë ose mjaft të mirë.²¹

Vlerësimi i rolit të forcuar **të Gjykatës Kushtetuese** në lidhje me monitorimin dhe zbatimin e vendimeve të saj është pozitiv, pas ndryshimit të Rregullores së Punës.

Norma e zbatimit të **vendimeve kryesore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut** ka rënë në krahësim me vitin e kaluar (65% krahasuar me 71%). Megjithatë, mbetet mbi mesataren e BE-së (45.7% e gjykimeve të pazbatuara mesatarisht në BE, krahasuar me 35% në Maqedoninë e Veriut). Gjithashtu është ulur edhe koha e zbatimit, si dhe numri i lëndëve për të cilat nuk është paguar dëmshpërblimi.

21 Komisioni Evropian 2025, Sondazhi i Eurobarometrit Flash 555 (2025). Të dhënat janë marrë nga ky burim. <https://europa.eu/eurobarometer/surveys/detail/3412>

Kritika e përsëritur e qasjes ndaj **organeve të pavarura** është një çështje shqetësuese. Zyra e Avokatit të Popullit dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë mungesë të burimeve financiare dhe njerëzore. Ndryshimet e shumëpritura të Ligjit për Avokatin e Popullit, të cilat synonin të hapnin rrugën për përmirësimin e statusit të tij të akreditimit në përputhje me Parimet e Parisit, nuk janë miratuar.

Gjetjet mbi **kornizën për veprim në shoqërinë civile** janë përgjithësisht pozitive, duke pasur parasysh se në vitin 2024 puna e Këshillit për bashkëpunim midis Qeverisë dhe shoqërisë civile u rihap, Qeveria miratoi një vendim për ndarjen e fondeve për organizatat e shoqërisë civile (OSHC), dhe është përgatitur Strategjia për bashkëpunim dhe zhvillim të shoqërisë civile për periudhën 2025-2029.²²

Megjithatë, Raporti kujton pretendimet e disa OSHC-ve për një mjedis gjithnjë e më të pafavorshëm.

22 Qeveria e Maqedonisë së Veriut 2025, Vendimi i miratuar në datën e publikimit të Raportit të Komisionit Evropian për Sundimin e Ligjit (8 korrik 2025).

Përfundime dhe rekomandime

Raporti vëren përparim në disa fusha. Megjithatë, tendencat negative në çështjet kryesore të sundimit të ligjit janë shqetësuese. Në këtë drejtim, Raporti është alarmant sa i përket presioneve mbi gjyqësorin dhe kërcënimit për pavarësinë e tij, veçanërisht nga dega ekzekutive. Një burim tjetër shqetësimi janë çështjet e përsëritura/dështimi i vazhdueshëm për të trajtuar probleme të caktuara të identifikuara në këtë analizë. Nëse këto tendenca negative vazhdojnë, ato kanë potencialin të dëmtojnë besueshmërinë e dosies së Maqedonisë së Veriut për gatishmërinë për negociatat e anëtarësimit, bazuar në zbatimin e suksesshëm të reformave në Klasterin "Themelet"—Sundimi i Ligjit.

Mungesa e vazhdueshme e burimeve financiare dhe njerëzore kontribuon ndjeshëm në përkeqësimin e cilësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit, si dhe në luftën kundër korrupsionit, si dhe sfidon funksionimin e organeve të pavarura. Në këto kushte kontribuon edhe varësia administrative nga miratimet e Ministrisë së Financave.

Për këtë arsye, këto janë rekomandimet:

- Të iniciohet një proces konstruktiv dialogu midis degëve të pushtetit për të përmirësuar situatën në gjyqësor, me pjesëmarrjen e shoqërisë civile. Dega ekzekutive të përmbahet nga presioni dhe ndërhyrja e mëtejshme në gjyqësor, dhe palët e interesuara gjyqësore duhet të marrin një qasje proaktive.
- Të zbatohen strategjitë për burimet njerëzore në gjyqësor.
- Të intensifikohet procesi i digjitalizimit të gjyqësorit, me theks në konsistencën dhe zbatueshmërinë e zgjidhjeve në praktikë, si dhe të trajtojë mungesën e burimeve të TI-së.
- Të miratohen ligjet/ndryshimet e planifikuara, strategjitë dhe planet e veprimit nga Agjenda e Reformave, për të cilat afati ka skaduar ose që duhet të miratohen deri në fund të këtij viti, përmes një procesi gjithëpërfshirës, për të parandaluar vonesa të mëtejshme në zbatim, për të cilat është e nevojshme të sigurohen burime të mjaftueshme—duke përfshirë Ligjin për Këshillin Gjyqësor, Ligjin për Këshillin e Prokurorëve Publikë, Ligjin për Prokurorinë Publike, Kodin Penal, Ligjin për Procedurën Penale, ligjet mbi pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, Planin e Veprimit për Parandalimin e Korrupsionit në Gjyqësor, etj.
- Duke pasur parasysh fondet e kufizuara buxhetore, synimi është të përmirësohet cilësia dhe efikasiteti i procesit të planifikimit, si dhe përdorimi i burimeve financiare dhe njerëzore në fushën e sundimit të ligjit.
- Të përgatitet dhe miratohet një strategji e re për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në kohë, përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke përfshirë të gjitha degët e pushtetit dhe shoqërisë civile, dhe bazuar në analizat ekzistuese.
- Të miratohet një qasje më proaktive nga KSHPK-ja për rastet e mundshme të korrupsionit dhe të zbatohet masa për të verifikuar në mënyrë efektive deklaratimet e pasurisë.
- Të sigurohet që Qeveria të marrë masa për të rritur reagueshmërinë e administratës (përfshirë qasjen në informacionin publik dhe ndjekjen e rekomandimeve të organeve të pavarura, etj.).

- Të rritet autonomia institucionale e shërbimit të transmetimit publik dhe të vazhdohet procesi i modernizimit.
- Të rivlerësohen reklamat shtetërore në media dhe të shqyrtohet mundësia e krijimit të një Fondi për Pluralizmin e Medias, i cili do të mbështeste zhvillimin e projekteve dhe përmbajtjeve në shërbim të interesit publik, duke nxitur një peizazh mediatik më të larmishëm, me cilësi të lartë dhe të pavarur.
- Të sigurohet që Qeveria t'i japë përparësi përmirësimit të procesit të hartimit të politikave (duke përfshirë parandalimin e ndryshimeve të tepruara të ligjit në këtë fushë, duke çuar në pasiguri ligjore).
- Të sigurohen burime financiare dhe njerëzore për organet e pavarura - Zyra e Avokatit të Popullit dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Të miratohen ndryshimet në Ligjin për Avokatin e Popullit, të nevojshme për përmirësimin e statusit të akreditimit në përputhje me Parimet e Parisit.
- Të sigurohet që Kuvendi, gjatë emërimit në organet e fushës së sundimit të ligjit, të respektojë parimin e meritës dhe të sigurojë transparencë në proces.
- Të sigurohet që Qeveria t'i marrë në konsideratë gjetjet mbi ndikimin që situata e sundimit të ligjit në vend ka mbi procesin e integritetit në Tregun e Vetëm të BE-së dhe, në bazë të tyre, të përgatisë masat e përshtatshme.
- Të krijohen sisteme efikase, racionale dhe funksionale për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjive për zhvillimin e gjyqësorit dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe strategjive të tjera në fushën e sundimit të ligjit, pa dyfishuar funksionet dhe proceset.
- Të sigurohet që Qeveria të krijojë një sistem konsultimesh dhe monitorimi për Raportin e Sundimit të Ligjit, duke marrë parasysh Metodologjinë e KE-së për përgatitjen e saj.
- Të rekomandohet që Komisioni Evropian të thellojë analizën e shkaqeve të kësaj gjendjeje, përtej evidentimit të mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore.

Shtojcë: Pasqyrë e përparimit, çështjeve të përsëritura dhe gjetjeve/çështjeve të reja

Shtylla	Progres	Çështje të përsëritura	Gjetje/çështje të reja
Sistemi i drejtësisë	- Transparenca në punën e gjyqësorit; - Përparim në zbatimin e rekomandimeve të Misionit të Shqyrtimit të Kolegëve 2023 nga ana e Këshillit Gjyqësor; ofrimi i arsytimit për vendimet mbi përzgjedhjen e gjyqtarëve (ndonëse jo konzistente) - Zbatim i Strategjisë për Gjyqësorin (edhe pse pamjaftueshëm); - Emërim i gjyqtarëve të rinj dhe prokurorëve publikë; - Përpyqje për digjitalizim dhe funksionim të sistemit automatik të menaxhimit të lëndëve.	- Ndërhyrja dhe presioni mbi gjyqësorin; - Mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore; - Nuk janë ndarë burime financiare në përputhje me Ligjin për Buxhetin Gjyqësor; - Strategjitë për burimet njerëzore në gjyqësor nuk zbatohen. - Infrastrukturë e vjetëruar, mbështetja e pamjaftueshme me IT dhe përdorimi jo konsistent i mjeteve digjitale; - Tendencë e vazhdueshme e uljes së efikasitetit të sistemit gjyqësor.	- Feferim i qartë i degëve të tjera të pushtetit, veçanërisht ekzekutivit, si burim presioni dhe ndërhyrjeje; - Vonesë e brezave të rinj në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.
Kuadri antikorrupsion	- Përpyqje për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë; - Kapacitete të përmirësuara pjesërisht.	- Shkallë shumë e ulët e zbatimit të Strategjisë për Parandalimin e Korrupsionit; - Aktiviteti i ulët i KSHPK-së në zbulimin dhe raportimin e rasteve të pretenduara të korrupsionit; - Mungesë e prokurorëve publikë dhe burimeve në përgjithësi për luftën kundër korrupsionit; - Numër i ulët i lobistëve dhe organizatave lobuese të regjistruara; - Mbrojtje e pamjaftueshme e sinjalizuesve; Ligji i ri për mbrojtjen e sinjalizuesve nuk është vënë në procedurë; - Mungesë e mbikëqyrjes efektive të financimit të partive politike; - Fushat e përsëritura me rrezik të lartë korrupsioni: prokurimi publik, punësimi në sektorin publik; - Nuk është vendosur një historik i fortë rezultatesh në trajtimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. - Efekte negative të ndryshimeve në Kodin Penal të vitit 2023.	- Mungesë e angazhimit politik dhe pronësisë nga institucionet shtetërore; - Aftësi e zvogëluar e KSHPK-së për të verifikuar deklaratimet e pasurisë; - Ndikim i mundshëm politik dhe qasje selektive në hetimet dhe ndjekjet penale të korrupsionit; - Rrezik i mëtejshëm i lartë i vonesave dhe boshllëqeve ligjore për shkak të mosmiratimit të Kodit të ri Penal, pra ndryshimeve të tij; - Edhe sektori i shëndetësisë është identifikuar si një fushë me rrezik të lartë korrupsioni (edhe pse kryesisht i tipit “të vogël”).

Shtylla	Progres	Çështje të përsëritura	Gjetje/çështje të reja
Media	- Gjetje pozitive mbi pavarësinë financiare dhe profesionalizmin e ASHMAA-së; - Njihen aktivitetet e Këshillit të Etikës Mediatike; - Numri i ankesave të lidhura me gjuhën e urrejtjes në vitin 2024 është më i ulët me një të tretën krahasuar me vitin 2023; - Përparim në financimin e RTM-së; - Përmirësim i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve për monitorimin dhe zbulimin e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve; - Ratifikim i Konventës së KE-së për Qasjen në Dokumente Zyrtare.	- Transparencë e pamjaftueshme e pronësisë së mediave dhe një rrezik mesatar-i lartë i përqendrimit mediatik; - Vonesë në emërimin e anëtarëve të Këshillit të ASHMAA-së; - Emërimi i anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së i vonuar që nga viti 2018; mungesë e autonomisë institucionale; - Mungesë e kuadrit ligjor specifik dhe ndërgjegjësimi për SLAPP; - Kushte të papërshtatshme të punës për gazetarët; - Zbatim në praktikë i të drejtës për qasje në informacionin publik.	- Mosrespektim i parimit të meritës gjatë emërimit të anëtarëve të rinj të Këshillit të ASHMAA-së; - Nevojë për financim të qëndrueshëm për Këshillin e Etikës Mediatike; - Paralajmërim se reklamimi shtetëror mund të çojë në keqpërdorimin e fondeve shtetërore dhe prishjen e tregut, por edhe varësinë e mediave nga fondet shtetërore që mund të minojnë pavarësinë editoriale; - Ngacmim në internet dhe dhunë me bazë gjinore ndaj gazetarëve femra; fushata denigruese kundër gazetarëve hulumtues.
Kontrolli dhe balancat institucionale	- Nuk ka konstatim të “polarizimit politik”; - Efekt pozitiv i ndryshimeve në Rregulloren e punës së Kuvendit nga viti 2023 në efikasitetin e tij në punë; - Koordinim efektiv midis Qeverisë dhe Kuvendit në procedurën legjislative; - Fuqizim i rolit të Gjykatës Kushtetuese në monitorimin dhe zbatimin e vendimeve të saj, pas ndryshimeve në Rregulloren e Punës; - Shkalla e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi mesataren e BE-së; - Filloi përsëri puna e Këshillit për bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, u përgatit një vendim për ndarjen e fondeve për OSHC-të dhe një Strategji për bashkëpunim dhe zhvillim të shoqërisë civile 2025-2029.	- Vonesa në emërimet parlamentare; - Mangësi në procesin e politikëbërjes gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në prova; - Mungesë e burimeve financiare dhe njerëzore të Zyrës së Avokatit të Popullit dhe të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi; - Ligj i pandryshuar për Avokatin e Popullit, i cili pengon avancimin e statusit të akreditimit të institucionit në përputhje me Parimet e Parisit.	- Emërimet parlamentare duke mos marrë parasysh parimin e meritës; - Gjetje të reja si rezultat i përfshirjes së dimensionit të Tregut të Vetëm: niveli i besimit në efikasitetin e mbrojtjes së investimeve (37% e kompanive).

